



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KE.nr.143/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit Kompania “A...”, Sh.p.k., me adresë: fshati – Fushë Kosovë, kundër të paditurit Botuesi i Portalit “O...”, me adresë: rr. “.... K5, nr.8, Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seancës, me datë 02.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se është tërhequr padia e paditësit “A...”, Sh.p.k., me numër C.nr.38/17 e datës 05.01.2017, me objekt kontesti kompensim dëmi, ndaj të paditurit Botuesi i Portalit “O...”.

A r s y e t i m

Paditësi “A...”, Sh.p.k., me adresë: fshati – Fushë Kosovë, pranë kësaj Gjykate me datën 05.01.2017, ka parashtruar padi për kompensim të dëmit, kundër të paditurit Botuesi i Portalit “O...”, me adresë: rr. “.... .., Prishtinë.

Paditësi me datën 13.04.2022, me anë të parashtrësës, e ka njoftuar Gjykatën se paditësi nuk ka interes juridik për të vazhduar procedurën dhe se për këtë çështje juridike e tërheq padinë e parashtruar.

Andaj Gjykata duke vepruar sipas parashtrësës së paditësit, në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 143/22, datë 02.09.2022.

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.